

KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletëpërgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë A B C D

Gabim A B C D


- Bëni kujdes për të mos dalë jasht rrethit kur të kodoni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si zhgarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan “PERGJIGJET”.
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Kodoni me kujdes preferencat tuaja për shkollat në të cilat dëshironi të studioni. Rezultatet dhe bursat do të shpallen sipas preferencave të bëra.

Shkolla	Kodi
“Mehmet Akif” e Mesme - Vajza në Tiranë (me konvikt)	01
“Mehmet Akif” e Mesme - Djem në Tiranë (me konvikt)	02
“Turgut Özal” 9-Vjeçare dhe e Mesme në Tiranë (me konvikt)	03
“Hasan Riza Pasha” 9-Vjeçare dhe e Mesme në Shkodër (e mesme me konvikt)	04
“Turgut Özal” 9-Vjeçare dhe e Mesme në Durrës (klasat 9-12 me konvikt)	05

Suksese!

1.

Jepet drejtkëndëshi ABCD me sipërfaqje 40 cm^2 ; [AE] është përgjysmore e këndit DAB, $|CE|=3\text{cm}$ dhe $|AE|=x \text{ cm}$. Sa është vlera e x-it..




A) $2\sqrt{2}$ B) $3\sqrt{3}$

C) $5\sqrt{2}$ D) $8\sqrt{2}$

2.

Jepet rrethi me qendër O, $|OB|=6 \text{ cm}$, $|AB|=4\pi \text{ cm}$. Sa është sipërfaqja e zonën vijëzuar ?



A) 8π B) 9π C) 10π D) 12π

3.

Shuma e shtatë numrave është 42. Sa është mesatarja e tyre ?

A) 294 B) 35 C) 7 D) 6

4.

$$\frac{2^{2018} - 2^{2017}}{2^{2019}} = ?$$

A) 4

B) 2

C) $\frac{2}{2}$

D) $\frac{1}{4}$

5.

Cila nga të mëposhtmet janë pikëprerjet e grafikëve të funksioneve, $f: y=x^2$ dhe $g: y=32-x^2$.

- A) (1;1) dhe (2;2)
- B) (4;4) dhe (-4;4)
- C) (-4;16) dhe (4;16)
- D) (0;0) dhe (16;4)

6.

$$\left(1-\frac{1}{3}\right) \cdot \left(1-\frac{1}{4}\right) \cdot \left(1-\frac{1}{5}\right) = ?$$

- A) $\frac{1}{5}$
- B) $\frac{2}{5}$
- C) $\frac{4}{5}$
- D) 1

7.

Cila nga të mëposhtmet paraqet vlerat e lejuara të ndryshores x në shprehjen

$$f(x) = \sqrt{x-5} + \sqrt{7-x} ?$$

- A) $\{5\}$
- B) $\{5; 7\}$
- C) $[5; 7]$
- D) $]5; 7[$

8.

$$\sqrt{81} + \sqrt{25} - \sqrt{1} - \sqrt{9} = ?$$

- A) 18
- B) 12
- C) 10
- D) 6

9.

Cila nga të mëposhtmet është vlera më e madhe e funksionit $f(x) = -3x^2 + 4x - 1$?

A) 0

B) $\frac{1}{3}$

C) -1

D) 1

10.

Jepen $A=[2;5]$ dhe $B=]0;6]$. Cila prej bashkësive të mëposhtme paraqet $A \cap B$?

A) $[2;5]$

B) $[2;5[$

C) $[0;6]$

D) $[0;2]$

10.

Cila nga të mëposhtmet është zgjidhje e sistemit të ekuacioneve :

$$\begin{cases} 2x + y = 2 \\ 3x - 2y = -\frac{15}{2} \end{cases}$$

A) $x=0, y=2$ B) $x = \frac{1}{2}, y = 3$

C) $x = -\frac{1}{2}, y = 3$ D) $x = \frac{1}{2}, y = -3$

12.

Cila nga të mëposhtmet është zgjidhje e inekuacionit : $x^2 - 4x - 12 \geq 0$

A) $]-\infty; -2] \cup [6; +\infty[$

B) $[-2; 6]$

C) $[-6; 2]$

D) $]-\infty; -6] \cup [2; +\infty[$

13.

Jepen $\frac{x}{2} = \frac{y}{3} = \frac{z}{4}$ dhe $2x + y + 3z = 76$

Gjeni vlerën e z ?

- A) 12 B) 16 C) 20 D) 24

14.


Zgjidhni ekuacionin: $-2x^2 + 5x - 2 = 0$

- A) $\{1; 2\}$ B) $\left\{\frac{1}{2}; 2\right\}$
 C) $\{-1; -2\}$ D) $\{1; 2\}$

15.

Jepet trekëndëshi kënddrejtë $\triangle BAC$,

- $E \in [AB]$
 $[ED] \perp [BC]$
 $|AC| = 24 \text{ cm}$
 $|BE| = 10 \text{ cm}$
 $|ED| = 8 \text{ cm}$
 $|BC| = x \text{ cm}$




Gjeni vlerën e x -it .

- A) 6 B) 18 C) 24 D) 30

16.

Në trapezin MNPS, $|SM| = |PN| = 5 \text{ cm}$ dhe $|MN| = 12 \text{ cm}$, $|PS| = 4 \text{ cm}$. Sa është lartësia e trapezit?



- A) 3 B) 4 C) 5 D) 12

17.

$$1 - (6 - 4 \div 2) \cdot (-1) = ?$$

- A) -3 B) 0 C) 2 D) 5

18.

Thjeshtoni $|x - 4| - |5 - x|$ nëse $x > 5$


- A) -9 B) 1
C) $2x - 1$ D) $2x + 9$

19.

Jepet funksioni $y = x^2 + 4$. Nëse x merr vlerat në bashkësinë $A = \{1, 4, 5, 7\}$, cila prej vlerave të mëposhtme është vlerë për y ?

- A) 6 B) 16 C) 29 D) 52

20.



Jepen $m\angle BAC = 120^\circ$ dhe

$|AB| = |AC|$, $|DB| = |BE|$, $m\angle AFD = x$.

Sa është vlera e x -it .

- A) 30 B) 35 C) 40 D) 45

21.

Zgjidhni ekuacionin: $\frac{x}{x-1} = \frac{1}{x-3} + \frac{1}{x-1}$


- A) $\{1; 3\}$
B) $\{-4\}$
C) $\{-1; -2\}$
D) $\{4\}$

22.

Jepet rrethi me qendër O dhe diameter

$[AD]$ dhe $m\angle BAD = 50^\circ, m\angle BOC = 60^\circ$

Sa është masa e harkut CD ?



- A) 35 B) 40 C) 45 D) 50

23.

Lartësia l e një drejtkëndëshi është sa 2-fishi i gjerësisë g . Cili sistem ekuacionesh mund të përdoret për të gjetur përmasat e drejtkëndëshit me perimetër 100 m?

- A) $\begin{cases} l = 2g \\ l + g = 100 \end{cases}$
 B) $\begin{cases} g = 2l \\ l + g = 100 \end{cases}$
 C) $\begin{cases} l = 2g \\ 2(l + g) = 100 \end{cases}$
 D) $\begin{cases} l = 2g \\ 2(l \cdot g) = 100 \end{cases}$


24.

Thjeshtoni $\frac{a^2 - 9}{3a - 9}$.

- A) $\frac{a + 3}{3}$
 B) $\frac{1}{3}$
 C) $\frac{-9}{a - 9}$
 D) $\frac{a - 3}{3}$

25.


Cila nga të mëposhtmet është vlera e x -it sipas të dhënave në figurë?



- A) $\sqrt{91}$ B) $\sqrt{93}$ C) $\sqrt{95}$ D) $\sqrt{97}$

26.


Sa kube janë në figurën e mësipërme?



- A) 36 B) 37 C) 38 D) 39

27.


Cila figurë vjen në vend të pikëpyetjes?



- A) B) C) D)

28.

Cili numër duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?



- A) 769 B) 740 C) 707 D) 687

29.


Cili numër duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?

6 12 17 ? 24 26

- A) 20 B) 22 C) 21 D) 23

30.

Cili numër duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?



- A) 12 B) 16 C) 18 D) 36


31.





Tre mace kapin tre minj për tre minuta, për sa minuta nëntë mace kapin nëntë minj?

- A) 3 B) 9 C) 27 D) 81

32.


Cila figurë vjen në vend të pikëpyetjes?







- 



- A) B) C) D)

33.


Cila figurë vjen në vend të pikëpyetjes?



- 



- A) B) C) D)


34.

Cili numër duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?

II.  =243

II.  =64



III.  =?

IV.  =625

- A) 16 B) 36 C) 64 D) 108

35.

Cila është figura që marrim kur rrotullojmë figurën e dytë 90° djathtas?



A)

B)

C)

D)

81.

Cili nga emrat femërorë të mëposhtëm është shkruar saktë:

- A) gjysëm
- B) kazmë
- C) basëm
- D) dasëm

82.

Poezia “Gjeniu i anijes” i përket llojit të :

- A) idilit
- B) sonetit
- C) lirikës meditative - filozofike
- D) himnit

83.

Është shkruar me varg 16 rrokësh:

- A) Soneti “Liria”
- B) Poezia “Gjeniu i anijes”
- C) Poema “Bagëti e Bujqësia”
- D) Poezia “Himni i flamurit”

84.

Nuk kemi fjali të nënrenditur përcaktore:

- A) Dihet që kështu do të kishte vepruar dhe ai.
- B) Ky është viti i dytë që janë rritur eksportet.
- C) Ajo ishte dita kur u takuam për herë të parë.
- D) Ai është qyteti ku filloi festa.

85.

Në cilën nga fjalitë është përdorur pjesëz dëftuese:

- A) Ja të vdesim, ja të rrojmë në liri.
- B) Ja ku e ke dosjen, para syve.
- C) Të thirra vetëm ty, jo tjetër!
- D) Me të, duhet të tregohemi veçanërisht të kujdesshëm.

86.

Në cilën fjali folja “jam” është përdorur si këpujë:

- A) Të gjithë kishim mësuar për këtë në shkollë.
- B) Ju keni pasur gjithmonë të drejtë përsa i përket kësaj pune.
- C) Ti je djalë i zgjuar dhe e kupton këtë.
- D) Vajza është menduar gjithë ditën për fjalët që i the.

87.

Dallo cila nga fjalitë e mëposhtme është fjali pavetore me folje pavetore:

- A) Ç’unazë e bukur!
- B) Jashtë po errësohej.
- C) Fliste tërë kohës për vete.
- D) Duaje atdhenë si shqiponja folenë.

88.

Në cilën nga fjalitë e dhëna kemi të përdorur folje gjysmëndihmëse modale:

- A) Duhej të mbaroja më herët, por nuk munda.
- B) I duhej një libër, por nuk po e gjente dot.
- C) Përfundoi së punuari kur u err.
- D) Habitem se si vazhdon të flasësh akoma.

89.

Dalloni në cilën fjali kemi parafjalë të rasës rrjedhore:

- A) Nga të dhënat e fundit i arritëm këto rezultate.
- B) Sipas të dhënave të fundit ju dolët të parët e konkursit.
- C) Me të dhënat e tua arritëm këtu.
- D) Në bazë të të dhënave të motit nesër do të bjerë shi.

90.

Cila nga fjalitë e mëposhtme është vetëm me nënrenditje:

- A) Jashtë frynte erë e ftohtë ndaj fëmijët u futën brenda.
- B) Ai filloi të lëvizte pa pushuar.
- C) Ngaqë kishte rrëshkitje dheu, ne u vonuam gjatë rrugës.
- D) Shiu nuk pushoi së rëni gjithë ditën.

91.

Ka lëvruar rrëfenjën dhe e mbështet krijimtarinë e tij në legjendat popullore:

- A) Mitrush Kuteli
- B) Bilal Xhaferri
- C) Ismail Kadare
- D) Martin Camaj

92.

Migjeni është pseudonimi letrar i:

- A) Martin Camajt
- B) Millosh Gjergj Nikollës
- C) Dhimitër Paskos
- D) Lasgush Poradecit

93.

Ka shkruar veprat; *“Tregtar flamujsh”*, *“Hija e maleve”*, *“Pasqyrat e Narcizit”*:

- A) Ernest Koliqi
- B) Bilal Xhaferri
- C) Ismail Kadare
- D) Martin Camaj

94.

Në cilën prej poezive, poeti krijon figurën e metaforës përmes ngjashmërisë me pemën:

- A) “Kadenca e violës”
- B) “Një vajzë”
- C) “Pa ty”
- D) “Bregu i mollës”

95.

Janë tekste rrëfimtare letrare:

- A) legjenda, miti, intervista, biografia
- B) romani, novela, tregimi, përralla
- C) poezia, idili, soneti, himni
- D) biografia, autobiografia, biseda, reportazhi

96.

Sipas Aristotelit “*katarzë*”, do të thotë:

- A) pastrim shpirtëror
- B) lutje
- C) dhembshuri
- D) dashuri

97.

Muji dhe Halili, janë personazhe të:

- A) Eposit homerik
- B) Eposit të kreshnikëve
- C) Iliadës
- D) Përrallave shqiptare

98.

Rretho alternativën e saktë: *Në cilën nga fjalitë e mëposhtme kemi trajtë të shkurtër të rasës dhanore:*

- A) E thirri të motrën dhe u largua.
- B) Zëri i atij ushtoi fuqishëm.
- C) Kjo gjë atij i dukej shumë e çuditshme.
- D) Ata u ngritën në këmbë dhe i pritën miqtë te dera.

99.

Janë shkruar nga Gjergj Fishta veprat:

- A) “Juvenilja”, “Andrra e jetës”, “Vaji i bylbylit”, “Liria”
- B) “Bagëti e Bujqësia”, “Lulet e verës”, “Histori e Skënderbeut”
- C) “Lahuta e malcis”, “Mrizi i zanave”, “Gjuha shqipe”
- D) “Këngët e Milosaos”, “Serafina Topia”, “Flamuri Arbrit”

100.

Në cilën nga fjalitë është përdorur koha e tashme e mënyrës kushtores:

- A) Mendova se këtu nuk do të flisja shqip, por vetëm anglisht.
- B) Po të vije me vonesë, nuk do të më gjeje këtu.
- C) -Nuk do të rrimë gjatë me pleqtë, - më pëshpëriti në vesh.
- D) Ndoshta do të të kisha pritur, por s’isha i sigurt.